

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6565  
E martë, 22 mars 2022  
çmimi 0.40 €

## Ukraina nuk pranon dorëzimin e Mariupolit



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) DHE ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK) KANË FILLUAR TAKIMET ME BASHKATDHTARËT

## PDK-ja DHE AAK-ja I KTHEHEN DIASPORËS



Dy partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë marrë më seriozisht votën e diasporës.

Përfaqësuesit e këtyre dy partive politike kanë nisur një komunikim me strukturat partiake dhe takime me bashkatdhetarë në Zvicër,

Gjermani dhe Francë. PDK-ja dhe AAK-ja në qytete të ndryshme të këtyre shteteve, para bashkatdhetarëve, po shpalosin vizionin e tyre për diasporën

### AKTUALE



KOMUNA E PRISHTINËS DHE SHSKUK-ja, MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI F. 6

SERBIA PARALAJMËRON HAPA TË ARDHSHËM PËR ZGJEDHJET E 3 PRILLIT F. 5

SHEFI I STAFIT TË KURTIT THOTË SE MEDIET NGJASOJNË ME KOMPANI TË KRIMINALIZUARA F. 3

### EKONOMI



KU KA NGEÇUR KOSOVA ME PAGËN MINIMALE? F. 8

AUV NDALON IMPORTIN E SHPEZËVE NGA ZONA E PREKUR ME GRIPIN E SHPEZËVE NË SHQIPËRI F. 8

### SPORT



GIRESSE: MIQËSORET DO TË SHËRBEJNË PËR T'U NJOHUR ME EKIPIN F. 10

Të enjten mbahet seancë për 23-vjetorin e bombardimeve të NATO-s



Pse qytetarët u detyruan ta blejnë vetë Remdesivirin, pasi me ligj u ofrohej falas?

Sipas të dhënave nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për një periudhë gjashtëmujore vetëm në një repart të Klinikës Infektive (nga gjithsej pesë reparte), 135 pacientëve me Covid-19 u është përkrahur Remdesiviri. Secili ka blerë nga 10 deri 14 doza (injeksione). Nëse secili nga këta 135 pacientë ka blerë mesatarisht 11 injeksione me një çmim mesatar prej 180 eurosh një dozë, atëherë ata kanë shpenzuar 267 300 euro



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Ukraina nuk pranon dorëzimin e Mariupolit

KIEV, 21 MARS - Izraeli është duke bërë përpjekje për t'i ndërmjetësuar bisedimet në mes të Ukrainës dhe Rusisë dhe në të ardhmen mund të jetë vendnikoqir i negociatave të nivelit të lartë, ka thënë presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky. "Kryeministri i Izraelit, (Naftali) Bennett, është duke tentuar të gjejë zgjidhje për mbajtjen e bisedimeve. Ne jemi mirënjohës për përpjekjet e tij, dhe herët apo vonë ne do t'i nisim bisedimet me Rusinë, me mundësi në Jerusalem. Ky është vendi i duhur për të gjetur paqe, nëse është e mundshme", ka thënë Zelensky përmes një videoadresimi, ku i është adresuar Parlamentit të Izraelit të dielën. Ukraina ka refuzuar një ultimatum rus që të dorëzohet qyteti i Mariupolit, ku rreth 300 000 njerëz besohet të jenë të bllokuar, duke siguruar kalim të sigurt nga porti nëse kjo ndodh. Kryetari i bashkisë së Mariupolit ka thënë për BBC se premtimet humanitare të Moskës nuk mund të besohen, duke u zotuar se forcat ukrainase do të luftojnë. Situata në qytet, i cili është i rrethuar nga trupat ruse dhe i shkatërruar nga bombardimet, është si "ferri në tokë", pasi furnizimet ushqimore dhe mjekësore po mbarojnë. Sulmet në qytetet e tjera të Ukrainës vazhdojnë, disa

shpërthime të forta u raportuan të hënë nga Kievi, ku autoritetet thanë se shtëpitë dhe një qendër tregtare u goditën, duke shkaktuar katër viktima. Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar ka theksuar se forcat ruse që përparojnë në kryeqytet nga verilindja kanë ngecur, ndërsa ndodhen 24 km nga qendra e qytetit. Ndërkohë, ka pasur një rrjedhje amoniaku në një fabrikë kimike në qytetin verilindor Sumy, i cili, gjithashtu, është i rrethuar nga forcat ruse. Zyrtarët u thanë banorëve të qytetit që të largohen në një reze prej tre miljesh, sepse gazi është i rrezikshëm. Gjykata e Moskës ka shpallur Metën "organizatë ekstremiste" dhe për këtë arsye ndaloj shërbimet e saj. Shërbimet Sekrete Ruse (FSB) i kishin kërkuar autoritetit gjyqësor që të vendoste një ndalim "të menjëhershëm" të rrjeteve sociale amerikane "Facebook" dhe "Instagram" në Rusi. "Aktivitetet e Metës janë kundër Rusisë dhe forcave të saj të armatosura. Prandaj kërkojmë që Meta të ndalohet në Rusi dhe ky ndalim të fillojë menjëherë", ka thënë Igor Kovalevski në seancën e parë të gjykimit, zëdhënës i FSB-së. Ndalimi u kërkuar edhe nga prokurori i Moskës.



### Litania: BE-ja nuk duhet të lodhet nga sanksionimi i Rusisë

Ministri i Jashtëm i Lituanisë, Gabrielius Landsbergis, ka thënë se Bashkimi Evropian "nuk duhet të lodhet" nga vendosja e sanksioneve kundër Rusisë, apo nga ofrimi i ndihmës për Ukrainën. Gabrielius Landsbergis ka paralajmëruar kundër "ndjenjës që të ulemi dhe të pushojmë". Ai ka folur para

gazetarëve në Bruksel, pasi ka arritur të takohet me ministra të punëve të jashtme dhe të mbrojtjes të Bashkimit Evropian. Sa iu përket sanksioneve, ai ka thënë se është e "pashmangshme" biseda për sektorin e energjisë. "Ne definitivisht duhet të flasim për naftën, pasi përmes saj sigurohen më së shumti të hyra në buxhetin e Rusisë dhe është lehtë e zëvendësueshme", ka thënë ai. Lituania, e cila gjendet në kufi me Poloninë, Letoninë,

Bjellorusinë dhe rajonin rus të Kaliningradit, ka qenë një nga kombet më të zëshme për sanksionim të Rusisë. Presidenti rus, Vladimir Putin, ka urdhëruar pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Ai ka urdhëruar "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në shumë vende të botës. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

## Kina përballet me valën më të rëndë të pandemisë prej 2020-s



SHANGAI, 21 MARS - Kina është duke u përballur me valën më të rëndë të pandemisë së koronavirusit që prej raportimit të rasteve të para dy vjet më parë. Komisioni Shëndetësor i Kinës ka regjistruar më shumë se 4 300 infektive lokale dhe raste asimptomatike të dielën. Disa miliona njerëz janë në izolim në Kinë, pasi shumë qytete kanë vendosur kufizime të pjesshme apo të plota në lëvizje. Shanghai, Shenzhen dhe Tangshan janë në mesin e qyteteve më të prekura. Autoritetet kineze janë duke

kryer edhe testime masive. Në provincën Henan studentëve u është thënë në shumë universitete që të mos largohen nga komplekset. Për më shumë se dy vjet Kina ka arritur ta menaxhojë pandeminë përmes strategjisë zero raste me Covid-19. Mirëpo prej përhapjes së variantit Omicron numri i të infektuarve është rritur shpejt. Autoritetet tani janë duke ndjekur një strategji "dinamike", e cila parasheh kufizime afatshkurtra për ta shmangur ndikimin në ekonomi dhe përditshmëri.

### Erëzohet një aeroplan me 132 njerëz në Kinë

Beijing, 21 mars - Aeroplani i kompanisë ajrore China Eastern Airlines - me 132 pasagjerë në bord - është rrëzuar të hënë në Provincën Guanksi, pasi është nisur nga qyteti kinez Kunming për në Guangzhou.

Pas rrëzimit në rajonet malore, aeroplani është përfshirë nga flakët. Ka shqetësime se nuk ka të mbijetuar, mirëpo numri i viktimave dhe arsyeja e rrëzimit ende nuk dihen.

Kompanitë ajrore kineze kanë histori të mirë sa i përket sigurisë, pasi aksidenti i fundit masiv ka ndodhur 12 vjet më parë. Ekipet e shpëtimit janë dërguar në zonën e rrëzimit të



# AKK-ja dhe AIP zotohen për bashkëpunim për ruajtjen e të dhënave personale

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MARS - Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, Yll Buleshkaj, është takuar të hënën me komisionaren për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dermaku, me të cilën ka diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve për forcimit dhe ngritjen e llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve.

Drejtori i AKK-së, Yll Buleshkaj, ka thënë se prioritet për realizimin e fushëveprimit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për parandalim dhe luftim të

korupsionit janë transparenca dhe llogaridhënia e institucionit, në veçanti bashkëpunimi me mediet dhe organizatat joqeveritare, gjithnjë brenda kornizave ligjore, duke ruajtur dhe trajtuar me kujdes konfidencialitetin e rasteve dhe informatave që janë të garantuara e ligji.

Në anën tjetër, komisionarja për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dermaku, e ka njoftuar drejtorin e AKK-së, Yll Buleshkaj, për veprimet dhe vendimet e AIP-së gjatë monitorimit të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërsa ka theksuar se bashkëpunimi ndër-institucional është i domosdoshëm për ta respektuar në përpikëri kornizën ligjore që



lidhet me llogaridhënien dhe transparencën dhe në mënyrë paralele duke garantuar ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në takimin mes dy udhëheqësve të institucioneve të pavarura u diskutua edhe për procesin e deklarimit të pasurisë. Drejtori i AKK-së, Yll Buleshkaj, ka

thënë se në raport të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me rastin e publikimit të regjistrave të deklarimit të pasurisë për afro 5 000 zyrtarë të lartë publikë, AKK-ja do të veprojë me përpikëri maksimale që të ruhen të dhënat personale të subjekteve deklaruese gjatë publikimit të deklarimit të pasurisë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Dy udhëheqësit e institucioneve u pajtuan për bashkëpunim të ndërsjellë për zbatimin e ligjeve që bien në përgjegjësinë e zbatimit dhe monitorimit të të dyja institucioneve të pavarura me qëllimin e përbashkët të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit duke respektuar legjislacionin në fuqi.

# Shefi i stafit të Kurtit thotë se mediet ngjasojnë me kompani të kriminalizuara, reagon AGK-ja

PRISHTINË, 21 MARS (ER) - Shefi i stafit të kryeministrit Albin Kurti, Luan Dalipi, me anë të një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka sulmuar mediet, konkretisht ato online. Sipas Dalipit, mediet ngjasojnë me kompani të kriminalizuara.

Shefi i stafit të Kurtit, Luan Dalipi, thotë se qeveria Kurti ka ndërprerë kontratat me portalet pasi, sipas tij, kjo metodë është aplikuar nga ish-qeveritarët për ta "blerë" heshtjen e portaleve. "Nuk është gjë e re përdorimi i ndonjë mediumi për ta shantazhuar qeverinë. Thurja e gënjeshtrove apo kurtheve dhe plasimi i tyre në portale i bën këto të fundit të



ngjasojnë me kompani të kriminalizuara që model biznesi kanë shpifjen dhe tentimin për ta shantazhuar qeverinë dhe/apo manipuluar publikun ose,

thjesht, për të fituar pandershem sa më shumë përmes klikimeve/shikueshmërisë së 'lajmeve' të tyre. Një lajm i mirë për qytetarët (dhe lajm i keq për shpifësit):

Qeveria Kurti nuk shantazhohet. Gjatë qeverisjeve të kaluara, kur ka pasur shumë raste të krimeve e korrupsioneve në sektorin publik, disa nga ish-qeveritarët e kanë 'blerë' heshtjen e portaleve. Kanë paguar nga buxheti i shtetit kontrata të panevojshme dhe të pakuptimta për disa media/portale. Këto kontrata e pagesa i kemi ndërprerë. Qytetarët tanë janë të varfër dhe qeveria Kurti nuk do t'i shpenzojë paratë e qytetarëve për t'i majmur portalet", ka theksuar ai. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka reaguar pas kësaj deklarate duke theksuar se Dalipi ka sulmuar në mënyrë të

paprecedent mediet në Kosovë, duke i lidhur ato me "biznese kriminale", dhe duke u bërë thirrje atyre që ai i ndanë në "qytetarë të dinjitetshëm", t'i bojkotojnë ato. AGK-ja konsideron se thirrja e tillë publike e njeriut më të afërt të kryeministrit Kurti në qeveri është shumë e rrezikshme dhe thirrje e hapur për linçim. "Gjuha e z. Dalipi është në vazhdimësi të sulmeve të individëve të shumicës parlamentare në Kosovë, që rrezikon direkt sigurinë e gazetarëve dhe rëndon klimën e të bërit gazetarit në vend", është thënë në reagimin e AGK-së.

# Të enjten mbahet seancë për 23-vjetorin e bombardimeve të NATO-s

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 MARS - Të enjten, më 24 mars, në orën 11:00, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mbledhet në seancë solemne, në shënim të 23-vjetorit të fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet policore dhe ushtarake serbe.

Ndërkaq, në orën 13:00, do të mbahet seancë e rregullt plenare. Kështu ka vendosur të hënën Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarë të grupeve parlamentare, të drejtuar nga kryeparlamentari Glauk Konjufca.

Pas shterimit të pikave të zakonshme, deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi pritet të debatojë për politikën e jashtme. Më tutje, Kuvendi do ta shqyrtojë për herë të parë Projektligjin për Kompensimin e Viktimave të

Krimit, si dhe atë për Pronën Publike, ndërsa në lexim të dytë Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile, si dhe atë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale. Seanca do të vazhdojë me shqyrtimin e dy raporteve: raportit me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit për Infrastruktura Kritike, si dhe ato lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020.

Do të votohet, po ashtu, për propozimin e Grupit Parlamentar të Listës Serbe për emërimin e anëtarit në Komisionin Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit për Ankesa të Medie, si dhe pritet të zgjidhen anëtarët e Komisionit për Ndhimë Shtetërore. Pikë e fundit e rendit të ditës e



kësaj seanca do të jetë themelimi i Komisionit Hetimor

Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike

nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.



PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) DHE ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK) KANË FILLUAR TAKIMET ME BASHKATDHEARË

## PDK-ja dhe AAK-ja i kthehen diasporës

Dy partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë marrë më seriozisht votën e diasporës. Përfaqësuesit e këtyre dy partive politike kanë nisur një komunikim me strukturat partiake dhe takime me bashkatdhetarë në Zvicër, Gjermani dhe Francë. PDK-ja dhe AAK-ja në qytete të ndryshme të këtyre shteteve para bashkatdhetarëve po shpalosin vizionin e tyre për diasporën

**EPOKA E RE**

**MAL QORRAJ**

**PRISHTINË, 21 MARS** - Edhe pse Kosova nuk është në ndonjë proces zgjedhor, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e kanë parë të arsyeshme të fillojnë një turne jashtë Kosovës, në vendet ku jetojnë bashkatdhetarët tanë. Përfaqësuesit e këtyre dy partive politike kanë nisur një komunikim me strukturat partiake dhe takime me bashkatdhetarë në Zvicër,

Gjermani dhe Francë. Këto dy subjekte politike në qytete të ndryshme të këtyre shteteve para bashkatdhetarëve janë duke shpalosur vizionin e tyre për diasporën. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, njëherësh udhëheqës i Departamentit për Diasporën, Elmi Reçica, pas tubimit madhështor në Rosenheim të Gjermanisë, ka vlerësuar se kjo agjendë "shënon fillimin e organizimit të madh të PDK-së në Gjermani, me struktura dhe nënstruktura, brenda të cilave do të jenë të angazhuar shumë veprimtarë. Rikthimi i Partisë Demokratike të Kosovës në qeverisje fillon pikërisht me rikthimin e saj në diasporë. PDK-ja do të jetë zëri i shumë veprimtarëve të devotshëm,

do të jenë të angazhuar shumë veprimtarë".

Mërgimtarëve në këtë tubim iu kanë drejtuar me fjalime edhe nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, Sami Lushtaku, Ramiz Lladrovci, Ganimete Musliu, Blerta Deliu, Donjet Bislimi dhe Kurtan Kajtazi. "Partia Demokratike e Kosovës rikthehet në Gjermani! Sot, nën përkujdesjen e Departamentit për Diasporë dhe me një punë të palodhshme të aktivistëve të Partisë Demokratike të Kosovës, në Rosenheim të Bavarisë është mbajtur tubimi madhështor i Partisë Demokratike të Kosovës, i cili shënon fillimin e organizimit të madh të PDK-së në Gjermani, me struktura dhe nënstruktura, brenda të cilave do të jenë të angazhuar shumë veprimtarë. Rikthimi i Partisë Demokratike të Kosovës në qeverisje fillon pikërisht me rikthimin e saj në diasporë. PDK-ja do të jetë zëri i shumë veprimtarëve të devotshëm,

zëri i anëtarësisë, i rinisë dhe veçanërisht zëri i grave të cilët me investimin e dijes dhe kapitalit, do të jenë shpresë e perspektivës së zhvillimit të vendit. Sot e filluam me Bavarinë dhe do ta përfundojmë me Berlinin", ka shkruar Reçica.

Ai ka treguar edhe për një takim që ka pasur me veprimtarë të devotshëm të çështjes kombëtare dhe me aktivistë të PDK-së të Republikës së Nordrhein-Westfalen të Gjermanisë, me të cilët ka thënë se ka biseduar për çështjet dhe problemet që shqetësojnë diasporën tonë si dhe për rikthimin dhe riorganizimin e PDK-së. "U vërejt një gatishmëri e lartë si asnjëherë më parë për fuqizimin e Partisë Demokratike të Kosovës në Diasporë si dhe rikthimin e saj në krye të shtetit me qëllim të kthimit të dinjitetit qytetar dhe qeverisjes së mirë. Diaspora jonë është promotore e të gjitha

ngjarjeve historike të cilët kanë pasur një rol të jashtëzakonshëm në luftën për liri dhe pavarësi si dhe në zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik të vendit", ka thënë Reçica.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, së bashku me koordinatoren për çështjet e Diasporës, deputeten Time Kadrijaj, ka zhvilluar takime me aktivistë të AAK-së dhe bashkatdhetarë në Zvicër, Francë dhe Gjermani.

Haradinaj ka treguar se bashkatdhetarët i ka informuar për situatën politike dhe atë të sigurisë në Kosovë, si dhe për rolin e AAK-së si subjekt opozitar. "Kam bërë thirrje që të ndihmohet Fondi i Sigurisë së Kosovës, si mekanizëm shtesë për më shumë siguri në vend, duke falënderuar bashkatdhetarët për kontributin e tyre në të gjitha kohët", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se bashkatdhetarët

## Krasniqi takon sekretaren e përgjithshme të RCC-së: Kosova duhet të trajtohet barabartë në çdo nismë rajonale

**PRISHTINË, 21 MARS (ER)** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të hënën në takim sekretaren e përgjithshme të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Majlinda Bregu. Përmes një postimi në "Facebook", Krasniqi ka njoftuar se me Bregun kanë biseduar lidhur me zhvillimet aktuale politike në Kosovë dhe

në rajon. "Zonjën Bregu e falënderova për angazhimin dhe kontributin për thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe për avancimin e proceseve integruese për shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe i shpreha qëndrimin tim se Kosova duhet ta ketë vendin merituar në çdo nismë rajonale si shtet i barabartë", ka shkruar lideri i PDK-së.



## Serbia paralajmëron hapa të ardhshëm për zgjedhjet e 3 prillit



**PRISHTINË, 21 MARS** - Udhëheqësi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, tha të hënën se autoritetet e Kosovës duan t'i pengojnë serbët e Kosovës që të votojnë më 3 prill në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të Serbisë. Petković e cilësoi si "gënjeshtrë" dhe "mashtrim" deklaratën e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, se ka vullnet të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. Sipas komunikatës së lëshuar nga zyra e tij, "qëndrimi i Republikës së Serbisë dhe

organeve të saj shtetërore lidhur me situatën e re do të shpallet nesër (22 mars), pas seancës së Këshillit të Sigurisë Kombëtare, kur edhe do të vendoset për hapat e ardhshëm". "Beogradi zyrtar pret që vendet e Quintit të marrin qëndrim të qartë dhe pa mëdyshje për shantazhin dhe sabotimin e Prishtinës, si dhe për shkeljen e të drejtave themelore, civile dhe demokratike të serbëve nga Kosova", thuhet në komunikatë. Autoritetet në Kosovë më 21 mars kanë bërë me dije se Serbia nuk ka bërë ndonjë kërkesë të

drejtpërdrejtë Qeverisë së Kosovës për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve brenda territorit të Kosovës. Më 14 mars Mimoza Kusari-Lila, shefe e grupit parlamentar e partisë qeverisëse në Kosovë, Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se Beogradi u është drejtuar institucioneve ndërkombëtare për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve në Kosovë por, siç ka thënë ajo, autoritetet sovraane në Kosovë janë Qeveria e Kosovës dhe institucionet e Kosovës. Ndërkaq, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar javën e

kaluar se është në kontakt me shtetet e Quintit që të gjendet një zgjidhje për serbët e Kosovës që duan të votojnë në këto zgjedhje. Kreu i ekzekutivit të Kosovës ka thënë se synon që të drejtat e serbëve të mos shkelen, por as të mos cenohet shtetësia e Kosovës. Në fillim të këtij viti institucionet e Kosovës lejuan që serbët e Kosovës të votojnë për një referendum kushtetues të Serbisë vetëm përmes Zyrës Ndërlidhëse të Serbisë dhe postës. Më herët ka pasur një praktikë

në Kosovë, ku misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka grumbulluar votat e qytetarëve serbë, më pas ato janë dërguar në Rashkë dhe Vranjë - dy qytete kufitare të Serbisë - për t'u numëruar. Kjo praktikë është krijuar qysh në vitin 2017 dhe autoritetet e Kosovës e kanë lejuar këtë gjë. Nga OSBE-ja kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se janë të gatshëm t'i grumbullojnë votat edhe për zgjedhjet e 3 prillit, por me pëlqimin e të gjitha institucioneve përkatëse.



i ka siguruar për mbështetjen e tij të plotë në procesin zgjedhor brenda partisë, duke uruar sukses për të gjithë ata që marrin pjesë në garën zgjedhore. "Aleanca është adresa e sigurt për diasporën shqiptare", ka deklaruar

Haradinaj. Në zgjedhjet e fundit lokale që janë mbajtur më 17 tetor të vitit të kaluar, subjekti që më së shumti ka fituar vota në total të të gjitha komunave nga diaspora ishte Lidhja Demokratike e Kosovës me 3 158 vota. Pas LDK-

së është renditur Lëvizja Vetëvendosje me 2 692 vota, e treta sipas rezultateve ka dalë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 1 482 vota si dhe e katërta është renditur Partia Demokratike e Kosovës me 1 198 vota.

Si duket ky rezultat i fundit i ka shtyrë për angazhim më të madh me diasporën PDK-në dhe AAK-në. Bazuar në një raport të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, llogaritet të jenë deri në 800 mijë qytetarë të Kosovës të cilët jetojnë

në vende të ndryshme të botës. Nga organizatat joqeveritare është vlerësuar i domosdoshëm përfaqësimi i diasporës në institucionet e Kosovës duke marrë parasysh edhe kontributin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.

## Rama pret në takim ambasadorin e Hungarisë, bisedojnë për sektorin e kulturës

PRISHTINË, 21 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka prituri në takim

ambasadorin e Hungarisë, Jozsef Bencze, i cili shoqërohej nga Laszlo Vizi, drejtor i Departamentit të Kulturës

nga Ministria e Punëve të Jashtme të Hungarisë. Rama ka thënë se me të ka diskutuar për transformimin e

Prishtinës në një kryeqendër kulturore nëpërmjet projekteve bilaterale mes dy vendeve.



## Komuna e Gjilanit përkrah bujqit për shtimin e kapaciteteve prodhuese

GJILAN, 21 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me ministrin e Bujqësisë, Faton Peci, kanë qëndruar në fshatin Gumnishtë, ku janë prituri nga kryetari i Shoqatës së Arrës dhe Lajthisë, Naim Rrahmani, i cili së bashku me profesorin dhe ekspertin e krasitjes, Vahid Avdiu, organizuan trajnimin praktik të krasitjes së arrës. Me këtë rast, kryetari Alban Hyseni është shprehur se komuna e Gjilanit është gjithmonë përkrah bujqve për shtimin e kapaciteteve prodhuese, derisa ka falënderuar Ministrinë e Bujqësisë për mbështetjen e madhe.

Ky trajnim doli të ishte i frytshëm për të gjithë kultivuesit e arrës dhe lajthisë. Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë se krasitja e gabuar e

fidaneve dëmton me 30 për qind rendimentin e të gjitha kulturave pemëtare, ndërsa moskrasitja e tyre i dëmton ato me mungesë rendimenti deri në 70 për qind. “Këtë vit kemi rritje substanciale në kategorinë e subvencioneve për të gjitha kulturat, njëherësh kemi rritur përkrahjen për të gjithë kultivuesit e pemëve, kurse përmes Granteve do ta mbështesim ngritjen e pemishteve të reja si dhe zgjerimin e potencialit për pemishtet ekzistuese si në kultivim ashtu edhe për përpunim”, ka thënë ai, duke shtuar se janë zotuar që brenda mandatit qeverisës do ta realizojnë digitalizimin e parcelave në mënyrë që të ketë një pasqyrë të saktë të pemishteve dhe kapacitetit të tyre në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.



## Asgjësohen 300 kilogramë mish të prishur në Skenderaj



SKENDERAJ, 21 MARS (ER) - Të dielën në Skenderaj policia ka hasur një kamion i cili po transportonte mish pa dokumentacion. Komuna e Skenderajt ka njoftuar se është identifikuar, asgjësuar dhe gëpusur një sasi e mishit prej 300 kilogramëve, pa dokumentin e deklarimit dhe i prishur. “Ngjarja ka ndodhur në mbrëmjen e së dielës, kur Policia e Kosovës ka identifikuar automjetin që po transportonte mishin. Në këtë rast është ftuar Drejtoria e

Inspeksionit të komunës së Skenderajt dhe Prokuroria, që kanë ndërmarrë veprimet ligjore ndaj personit të kapur në flagrancë. Sasia e mishit është asgjësuar dhe gëpusur sipas procedurave të kërkuara, nga kompania ‘Uniteti’, ka njoftuar komuna e Skenderajt. Pas këtij rasti ka reaguar edhe kryetari i komunës, Fadil Nura, i cili ka thënë se shëndeti publik dhe jeta e qytetarit janë të shenjta. “Dhe derisa janë të tilla, do të

godasim me forcën e ligjit kudo që ka veprime të paligjshme në tregti, veçmas në rastet kur haset në shitje të gjerave ushqimore me afat të skaduar. Falë koordinimit dhe bashkëpunimit në mes të komunës së Skenderajt, policisë dhe prokurorisë, janë identifikuar, asgjësuar dhe gëpusur rreth 300 kg mish”, është shprehur Nura, duke i ftuar të gjithë qytetarët ta lajmërojnë Inspektoratin dhe organet e tjera relevante për çdo parregullsi apo shkelje ligjore.

## Mitrovica dhe Gjakova shkëmbejnë përvojat për punën e kuvendeve komunale



MITROVICË, 21 MARS (ER) - Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Vesa Broja, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, kanë prituri të hënën në takim homologet nga Gjakova, kryesuesen

Arbëneshja Kuqi, si dhe drejtoreshën Adea Roka. Në këtë takim janë shkëmbyer përvojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen këto institucione, ndërsa me theks të veçantë kanë diskutuar për rregulloret dhe planet e punës së kuvendeve komunale.

Kryesuesja Broja ka falënderuar mysafiret nga komuna e Gjakovës për vizitën e realizuar në komunën e Mitrovicës me qëllim të ndarjes së përvojave të mira dhe sfidave të kuvendeve komunale dhe të komunës në përgjithësi.


## Komuna e Prishtinës dhe ShSKUK-ja, marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 21 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, dhe drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të

Kosovës, Valbon Krasniqi, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe

komunës së Prishtinës. Me këtë marrëveshje ofrohet shërbim më efikas për pacientët e shtrirë në Klinikën e Nefrologjisë në QKUK, e në

rastet kur aty mungojnë hapësirat për trajtim, pacientët do të vazhdojnë të trajtohen edhe më tutje në QMF-në e lagjes “Kodra e Trimave”.



SI DËSHTOI MINISTRIA E SHËNDETËSISË PËR TA SIGURUAR REMDESIVIRIN  
PËR PACIENTËT E PREKUR ME COVID-19

# Pse qytetarët u detyruan ta blejnë vetë Remdesivirin, pasi me ligj u ofrohej falas?

Sipas të dhënave nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për një periudhë gjashtëmujore vetëm në një repart të Klinikës Infektive (nga gjithsejtë pesë reparte), 135 pacientëve me Covid-19 u është përshkruar Remdesiviri. Secili ka blerë nga 10 deri 14 doza (injeksione). Nëse secili nga këta 135 pacientë ka blerë mesatarisht 11 injeksione me një çmim mesatar prej 180 euro/dozë, atëherë ata kanë shpenzuar 267 300 euro

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 MARS - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar raportin "Pse qytetarët u detyruan ta blejnë vetë Remdesivirin? - Si dështoi Ministria e Shëndetësisë për ta siguruar Remdesivirin për qytetarët e prekur nga Covid-19?". Raporti shpërfaq dështimin e Ministrisë së Shëndetësisë për t'ua siguruar ilaçin Remdesivir pacientëve të infektuar me Covid-19.

Qytetarët përreth një vit janë detyruar që këtë ilaç ta blejnë vetë, ndërsa Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 i obligon institucionet që shërbimet për trajtimin dhe parandalimin e Covid-19 të ofrohen falas.



Sipas të dhënave nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për një periudhë gjashtëmujore vetëm në një repart të Klinikës Infektive (nga gjithsejtë pesë reparte), 135 pacientëve u është përshkruar Remdesiviri. Secili ka blerë nga 10 deri 14 doza (injeksione). Nëse secili nga këta 135 pacientë ka blerë mesatarisht 11 injeksione me një çmim mesatar prej 180 eurosh/dozë, atëherë ata kanë shpenzuar 267 300 euro.

Agon Hysaj nga KDI-ja ka thënë se qytetarët janë detyruar të blejnë vetë terapinë kundër virusit, duke paguar 300 euro për një njësi. Sipas tij, 135 pacientë kanë shpenzuar 267 mijë euro për blerjen e Remdesivirit.

Ai pohon se Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë thotë se të gjitha shpenzimet duhet të mbulohen nga institucionet, prandaj qytetarët duhet të kërkojnë rimbursim. "Qytetarët kanë vazhduar ta blejnë vetë këtë produkt. Çmimi ka qenë deri në 300 euro për njësi. Kjo njësi ka mundur të blihet edhe përmes BE-së. Kur BE-ja vendos të blejë produkt edhe Kosova mund të bëhet pjesë e prokurimit. Nuk ka ndonjë të dhënë që Kosova ka blerë direkt Remdesivirin", ka thënë ai, duke shtuar se vetëm në një repart klinike 135 pacientë kanë shpenzuar 267 mijë euro. "Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë thotë se të gjitha shpenzimet duhet të



mbulohen nga institucionet. Përmes këtij ligji qytetarët janë dënuar. Qytetarët duhet të kërkojnë rimbursim për shpenzimet jo vetëm për Remdesivirin, por edhe për barna", ka thënë Hysaj.

Ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka folur për procedurat që kanë ndjekur për të porositur këtë lloj të barit. Sipas tij, më shumë se 5 000 stoqe janë blerë nga ShBA-ja në atë kohë ku oferta për blerjen e këtij bari ka qenë më shumë se 350 euro.

Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, ka thënë se edhe pse ministria ka arritur ta sjellë barin në Kosovë, qytetarët e kanë blerë vetë atë. Prandaj, sipas tij, duhet t'u mundësohet rimbursimi atyre. "Në momentin që në protokoll në udhërrëfyes klinikë është futur bari Remdesivir dhe është përshkruar nga mjekët, Ministria e Shëndetësisë, nëse nuk ka arritur ta blejë, është dashur ta bëjë rimbursimin dhe t'i ftojë qytetarët që kanë blerë të aplikojnë për rimbursim. Bazuar në raportin e auditimit shihet se pacientët e kanë blerë atë bari, por nuk ka informatë që një produkt i tillë është sjellë në Kosovë. Kërkesa ime është që pacientët të aplikojnë për

rimbursim", ka thënë deputeti i PDK-së.

Ndërkaq deputeti i AAK-së, Shemsedin Dreshaj, ka thënë se në treg ka pasur produkte me prejardhje të paverifikuara. Sipas tij, kostoja e trajtimit të secilit pacient çdoherë ka kaluar mbi 3 000 euro. "Në treg ka pasur produkte me prejardhje të ndryshme të paverifikuara. Ne nuk e kemi pasur në klinikë Remdesivir. Kemi pasur telashe edhe me barna të tjera esenciale. Kostoja e trajtimit të secilit pacient çdoherë ka kaluar mbi 3 000 euro", ka thënë deputeti Dreshaj.

Remdesiviri është një medikament antiviral i zbuluar nga kompania farmaceutike Gilead Sciences, i cili shitet me emrin tregtar Veklury. Pas shfaqjes së Covid-19 në disa shtete Remdesiviri u aprovua për trajtim të pacientëve të prekur me Covid-19. Në Shtetet e Bashkuara, Administrata e Barërave dhe Ushqimit (FDA) më 1 maj 2020 lëshoi një autorizim emergjent për përdorimin e Remdesivirit, ndërsa në Indi u aprovua më 1 qershor 2021. Deri më tani rreth 50 shtete kanë lëshuar autorizime për përdorim emergjent të këtij bari.

Në Kosovë përdorimi i

Remdesivirit për trajtimin e pacientëve me Covid-19 u rekomandua përmes Udhërrëfyesit Klinik për Menaxhimin dhe Trajtimin e Covid-192, të publikuar më 11 gusht 2020.

Kërkesa e ShSKUK-së për ta blerë këtë produkt u iniciua pas një muaji e gjysmë, respektivisht më 24 shtator 2020, ku ishte planifikuar të blihen 1 320 njësi (për 120 pacientë nga 11 ampula). Në bazë të hulumtimit të tregut që e kishte bërë komisioni i themeluar nga MSh-ja për përcaktimin e çmimit, çmimi mesatar në treg për një njësi Remdesivir ishte 252.65 euro. Ky komision gjatë përcaktimit të çmimit të tregut mori si referencë çmimet në dy depo farmaceutike dhe në një barnatore. Mirëpo, në bazë të një table të ShSKUK-së të muajit gusht 2020, kërkesa për Remdesivir ka qenë 7 780 njësi.

Në anën tjetër, qytetarët gjatë kësaj kohe vazhdonin ta blinin vetë Remdesivirin, përkundër që Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 thotë se çdo personi që është i prekur me Covid-19 i ofrohen falas të gjitha shërbimet shëndetësore, përfshirë edhe barnat për trajtimin e virusit.

## Uran Ismaili paraqet drejtoreshën e Kulturës të komunës së Prishtinës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MARS - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë, Uran Ismaili, ka paraqitur të hënën Arta Balajn, drejtoreshë e Kulturës në komunën e Prishtinës.

Ismaili ka thënë se përgatitja e lartë profesionale dhe përvoja e madhe në sektorin publik dhe privat në Kosovë e bëjnë Artën një kuadër mirë të kualifikuar për këtë pozitë. "Si një grua e

përgatitur mirë, me shkollim ndërkombëtar dhe e dëshmuar për rreth dy dekada në sektorin publik e privat, Arta ka besimin dhe mbështetjen time të plotë në detyrën e re. Ajo ka punuar në disa shtete të ndryshme, ndërsa ka bashkëpunuar edhe me shumë organizata ndërkombëtare që shërbejnë në Kosovë. Përvojën e saj të madhe do ta sjellë tani në Prishtinë, për t'i dhënë gjallëri jetës dhe aktiviteteve kulturore në kryeqytetin tonë", ka thënë Ismaili.

Partia Demokratike e Kosovës

deri më sot kishte emëruar nënkryetaren dhe katër drejtorë, nga pesë sa i takojnë nga marrëveshja për bashkëqeverisje.

Me emërimin e Artës kompletohet ekipi i PDK-së për kryeqytetin.

Donjeta Sahatçiu (nënkryetare), Besianë Musmurati (drejtoreshë e Arsimit), Plator Gërdovci (drejtor i Bujqësisë), Ilirik Musliu (drejtor i Shërbimeve Publike), Granit Rugova (drejtor për Sport) dhe Arta Balaj (drejtoreshë e Kulturës).



# Ku ka ngecur Kosova me pagën minimale?



**PRISHTINË, 21 MARS** - Me rritjen e inflacionit paga minimale në Kosovë mbetet e pandryshuar me atë të vitit 2011.

Vlera e kësaj page është 170 euro - sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave, më e ulëta në Evropë. Inflacioni, në anën tjetër, ka arritur në 7.5 për qind muajin e kaluar, krahasuar me 0.7 për qind sa ka qenë në shkurt të vitit 2021.

Këshilli Ekonomik Social i Kosovës, sipas Ligjit të Punës, propozon vlerën e pagës minimale në fund të çdo viti kalendarik, e cila më pas kalon për miratim të qeveria. Ai ka bërë përpjekje për rritjen e saj por, pa sukses.

E fundit është bërë këtë muaj, por anëtarët e Këshillit, që përfshijnë punëdhënës, përfaqësues të punëtorëve dhe zyrtarë të qeverisë, thuhet se nuk janë pajtuar për shumën.

Atdhe Hykolli, kryetar i Bashkimit të Sindikatave të

Pavarura të Kosovës, që është pjesë e Këshillit Ekonomik Social, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se në mbledhjen e fundit të Këshillit, të mbajtur më 10 mars, janë dhënë dy propozime për pagën minimale: njëri 264 euro, tjetri 300 euro.

Propozimet janë dhënë nga komisioni për çmime brenda Këshillit Ekonomik Social, por asnjëri nga to nuk ka kaluar. Nevojiten së paku 2/3 e votave të këshillit 15-anëtarësh që një propozim të kalojë. "Ne nuk kemi votuar as për, as kundër. Këshilli Ekonomik Social mbledhet një herë në muaj. Do të takohemi përsëri dhe do të diskutojmë përsëri rritjen e pagës minimale", thotë Hykolli, i cili është edhe kryesues i Këshillit Ekonomik Social.

Në të kaluarën Sindikata që udhëheq ai sot ka thënë se paga minimale duhet të jetë jo më pak se 300 euro.

Ministri i Financave i Kosovës,

Hekuran Murati, në një postim në "Facebook" më 10 mars, ka njoftuar se propozimi për rritje të pagës minimale ka dështuar, duke thënë se ai nuk është mbështetur nga përfaqësuesit e sindikatave.

Murati ka thënë se Këshilli Ekonomik Social ka propozuar pagë minimale prej 240 eurosh në muaj, ndërsa qeveria ka propozuar 1.5 euro për orë, apo 264 euro në muaj. "Krejt çka arrihet me këtë mosvotim është se punëtorët e sektorit privat do të vazhdojnë ta kenë pagën minimale 170 euro", ka thënë Murati më 10 mars.

## Punëdhënësit: Paga minimale 250 euro

Nga Aleanca Kosovare e Biznesit, e cila në Këshillin Ekonomik Social përfaqëson bizneset, thonë se këshilli ka ardhur në përfundim se paga

minimale duhet të jetë 250 euro neto. Por, Lumnije Ajdini nga kjo aleancë thotë për "Radion Evropa e Lirë" se kjo vlerë është kundërshtuar nga përfaqësuesit e punëtorëve. "Për ne si punëdhënës, atë ditë, më 10 mars, do të ishte votuar paga minimale, por nuk është votuar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës; 250 euro mund të jenë pak, por duhet kuptuar se kjo është minimale, pasi që punëtorët në sektorin privat kanë rroga më të larta", thotë Ajdini.

## Sa kushton shporta mujore e konsumatorit?

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, thotë se në bazë të një analize të bërë, shporta mujore e një familjeje katëranëtarëshe në Kosovë kap vlerën prej 470 eurosh. Sipas tij, propozimet për

pagën minimale janë të papranueshme. "Pagesa e energjisë, shërbimet komunale, transporti, ushqimi e gjërat e tjera bazike - të gjitha këto, duke nxjerrë minimalen e shpenzimeve jetësore, kushtojnë 470 euro. Këtu janë llogaritur vetëm gjërat elementare", thotë Azemi, organizata e të cilit nuk është pjesë e Këshillit Ekonomik Social.

Kosova nuk ka të dhëna të sakta se sa është numri i të punësuarve që marrin pagë minimale, por besohet se ajo u takon më së shumti të punësuarve në sektorin privat. Sektori privat në Kosovë llogaritet punëdhënësi më i madh: me mbi 220 mijë punëtorë. Sipas Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, në pagën minimale përfshihen punëtorët në sektorin e pastrimit, shërbyesit shtëpiakë, punëtorët e sigurimeve private e të tjerë.

Paga mesatare bruto në Kosovë është rreth 460 euro.

Në sektorin publik paga mesatare bruto është rreth 620 euro, ndërsa në sektorin privat rreth 380 euro. Vlera e pagës minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar qysh në vitin 2011. Këshilli Ekonomik Social ka propozuar në vitin 2018 që paga minimale të jetë 250 euro, por propozimi nuk ka shkuar tutje. Atdhe Hykolli nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës thotë se nëse çdo vit do të negociohej paga minimale, kjo pagë aktualisht do të ishte afro 450 euro. Në bazë të nenit 86 të Ligjit të Punës, faktori kryesor që duhet të merret parasysh gjatë përcaktimit të pagës minimale është kostoja e shpenzimeve jetësore, pastaj përqindja e shkallës së papunësisë, gjendja e përgjithshme në tregun e punës dhe shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend. "Nëse të gjitha këto kritere merren për bazë, nuk do të gabonte askush në përcaktimin e pagës minimale", thotë Hykolli.

## AUV ndalon importin e shpezëve nga zona e prekur me gripin e shpezëve në Shqipëri

**PRISHTINË, 21 MARS (ER)** - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka ndaluar importin e shpezëve të gjalla nga zona e prekur me sëmundjen gripi i shpezëve H5N8 në Shqipëri. "Duke u bazuar në raportin e Organizatës Ndërkombëtare për Epizooti me numër reference D381-1-1-22, për lajmërimin e paraqitjes së sëmundjes gripi i shpezëve - avianInfluenza tipi H5N8 në zonën e Durrësit në Shqipëri. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë sot, me datë

21.03.2022, nxjerrë vendim me nr. 03/205/22 për masat e ndalesës së importit të shpezëve të gjalla nga zona që është konfirmuar prezenca e sëmundjes. Vendimi është nxjerrë bazuar në Ligjin nr. 2004/21 për Veterinarinë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 2005/24 për Luftimin e Sëmundjes Zoonotike të Shpezëve 'Gripi i Shpezëve'. Bazuar në vlerësimin e situatës epizootologjike pas paraqitjes së disa rasteve në shtetin fqinj", ka njoftuar AUV.

Ky institucion ka bërë me dije se

janë në kontakt të vazhdueshëm me autoritetin e veterinarisë së Shqipërisë për shkëmbim informata lidhur me incidencën e mundësisë së përhapjes së kësaj sëmundje. "Si autoritet më i lartë i veterinarisë në Republikën e Kosovës, me të gjitha kapacitetet jemi të angazhuar për ndërmarrjen e veprimeve parandaluese të përhapjes së sëmundjes në vendin tonë. Kontrolli veterinar kufitar ngritët në nivel të mbikëqyrjes së detajuar të importeve të ngarkesave me shpezë", ka njoftuar Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.





# A janë koha dhe vdekja një iluzion i shpikur nga njerëzimi?



**Nga Andrei TALAPAGA**  
"History of Yesterday"

Bota e shkencës në zhvillim të vazhdueshëm, është ndonjëherë në kundërshtim me të gjitha leksionet që kanë lënë filozofët përgjatë historisë. Fusha e fizikës është studiuar gjerësisht gjatë shekullit XX-të për të gjetur një përkufizim më të mirë se çfarë është koha.

Disa thonë se koha është shpikur nga ne njerëzit, pasi na pëlqen që t'i masim gjërat. Por këtu do të ndalemi tek teoria e biocentrizmit e Robert Lanzas. Ai është një shkencëtar kompetent në fusha të shumta të shkencës, dhe e shpiku këtë teori vetëm disa vite më parë. Lanza pretendon se biologjia është fusha më e rëndësishme e shkencës mbi gjithë të tjerat. Në përgjithësi, biocentrizmi përcakton nga një perspektivë etike, se e gjithë jeta meriton një konsideratë të barabartë në aspektin moral, apo se ka një pozitë morale të barabartë. Përkufizimi i detajuar i biocentrizmit u paraqit në librin me të njëjtin titull të vitit 2011, ku Lanza shkruan se koha, ashtu si edhe vdekja, janë iluzione të krijuara nga mendja njerëzore. Një teori e argumentuar shumë mirë, por edhe e mirë-menduar.

Për të thjeshtuar teorinë e tij: Nëse ju jeni të indoktrinuar për shumë vite se do të shihni një dritë në fund të tunelit kur të vdisni, mendja juaj do ta shohë patjetër dritën. Sipas tij, njerëzimi nuk është në gjendje të matë jetët në sasinë e pafundme të universëve.

Ideja themelore e kësaj teorie është se Universi lind nga jeta jonë. Lanza

e shih jetën dhe Universin si të ndërlidhur, dhe fillimi i Universit ose krijimi i tij është një fenomen më shumë biologjik sesa një aksident i fizikës.

Biocentrizmi po përpiqet t'i japë ndërgjegjes njerëzore shpjegimin më të mirë dhe më logjik shkencor, diçka që ne ende nuk e kuptojmë sepse nuk mund ta masim. Siç u përmend më lart, njerëzimit i pëlqen që të matë gjërat. Nëse diçka nuk mund të matet, ajo nuk ekziston. Por çfarë mund të themi nëse vetëdija është e pamatshme? Bazuar në kulturat historike me kalimin e kohës, çdo kulturë beson se vetëdija jonë jeton në një farë mënyre. Ne nuk mund ta shohim atë kur largohet nga trupi i dikujt. Po sikur ajo të ekzistojë vetëm në mendjen tonë? Ky është biocentrizmi në terma shumë të thjeshtëzuar.

Fizika si një disiplinë shkencore, është ende mjaft e re, e megjithatë ka bërë hapa të jashtëzakonshëm në matjen e jetës. Po ç'mund të themi për teorinë e krijuara nga filozofët mbi jetën, vdekjen dhe kohën? Cilët kanë folur më herët përveç Aristotelit të famshëm (384-322 Para Erës Sonë), që për mendimin tim është babai i filozofisë.

Aristoteli krijoi fatalizmin, ndoshta një nga teoritë e para që u përpoqën të shpjegonin kohën dhe jetën. Përmes kësaj teorie, ai argumentoi se çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen është tashmë e pashmangshme. Fatalizmi është përpjekja për ta përcaktuar fatin e një personi në jetë.

Duket sikur jeta është një libër i shkruar para se ju të lindnit, dhe

tani thjesht po jetoni sipas asaj që është shkruar. Çdo vendim që do t'ju duhet të merrni në këtë jetë është marrë tashmë. Fatalizmi dhe doktrina e Aristotelit në përgjithësi, mund të pajtohen me biocentrizmin, në kuptimin që universi krijohet dhe mbështetet nga jetët tona, pasi gjithçka që ndodh është e destinuar të ndodhë tashmë, ndërsa Universi rritet nga veprimet tona të pashmangshme. Platoni (427-347 Para Erës Sonë) i kaloi shumë vite të jetës së tij si filozof, duke u përpjekur të kuptonte jetën, duke marrë parasysh kohën dhe vdekjen. Doktrina e tij filozofike e njohur si Platonizëm, shqyrton ekzistencën e jetës abstrakte e cila nuk përcaktohet nga hapësira apo koha.

Për shembull, objektet nuk kanë mendje, prandaj nuk mund të krijojnë një shkak dhe pasojë, që do të ndryshonte të ardhmen. Ato janë të pandryshueshme dhe tërësisht inerte në aspektin shkakësor. Nëse vetë koha i respekton ligjet e fizikës, dhe ajo nuk mund të përfundojë ose të ndryshojë modelin e saj, atëherë ajo mund të konsiderohet abstrakte, pasi nuk ka një mendje të vetën që do të krijonte një shkak dhe pasojë.

Aristoteli kishte argumentuar në doktrinën e tij, se koha nuk mund të ketë një fillim, pasi kjo do të nënkuptonte se koha dikur kishte një fund, në mënyrë që të niste nga fillimi. Nga këndvështrimi i Platonit, koha duhet të jetë e pacaktuar ose e pafundme në mënyrë që të ekzistojë si një abstrakt, por kjo nuk do të përputhej me teorinë e biocentrizmit.

Imagjinojeni strukturën e kohës si një vijë të drejtë. Nëse koha do të kishte një fillim, atëherë diçka tjetër duhet të kishte ardhur para kohës, por nëse është koha ajo që e përcakton jetën, atëherë biocentrizmi është një teori e gabuar, pasi kjo do të thotë se është Universi ai që krijoi jetën dhe jo anasjelltas.

Ashtu si ligjet e fizikës, të cilat nuk mund të ndryshojnë sipas dëshirës së dikujt, edhe koha nuk mund të kontrollohet pasi mund të ecë vetëm përpara. Kjo përshkruhet shumë mirë me frazën "Shigjeta e kohës" e cila u krijua në vitin 1927 nga shkencëtari Artur Edington (1882-1944).

Ajo frazë përpiqet të shpjegojë se koha mund të shkojë vetëm në një drejtim, ashtu si një shigjetë. Një nga pikëpamjet dhe pyetjet e mia personale për këtë, është se pse vetëdija jonë duhet të ndjekë shigjetën e kohës, nëse këto gjëra ndodhin vetëm në mendjen tonë? Nëse veprimi i shkruarjes së këtij artikulli, është vetëm një iluzion i krijuar nga mendja ime, pse nuk mund të kthehem për ta ndryshuar këtë fjali në të ardhmen? Biocentrizmi nuk arrin të shpjegojë kohën apo një zëvendësues të saj. Kur biocentrizmi argumenton se vdekja është vetëm një iluzion, i referohet idesë se vetëdija jonë nuk do të vdesë kurrë, se ajo ecën vetëm përpara. Por nëse koha nuk ekziston, cilat ligje do e detyronin atë të ecë vetëm përpara? Nëse Aristoteli është i saktë me teorinë e tij të fatalizmit, atëherë a ka bota një fund të pacaktuar?

Biocentrizmi thotë se Universi e kishte një fillim, por evolucioni i tij u ndikua nga jeta, dhe ne jemi

vetëm në fillimin e formësimit të Universit. Hapësira dhe koha shihen nga biocentrizmi si mjete të përdorura nga mendjet tona për të lidhur gjithçka së bashku.

Siç e ka përcaktuar Platoni në shkrimet e tij, koha është si një enë boshe, në të cilën çdo gjë që mund të vendosni nuk do ta ndikojë kurrë atë. Filozofi gjerman Gotfrid Lajbnic (1646-1716) thotë se koha ndikohet nga veprimet tona, dhe për këtë arsye ajo ekziston pasi këto ndryshime janë të matshme në kohë.

Për shembull, dita ecën ngadalë por me siguri zgjatet, dhe për momentin një ditë e plotë është 23 orë e 56 minuta. Në ideologjinë e biocentrizmit, koha e ditës mund të jetë aq e gjatë sa ne duam të jetë, pasi është një iluzion në mendjet tona. Njerëzimi e krijoi kohën vetëm për të matur sesa kohë mbijeton në Tokë.

Lidhja midis vdekjes dhe kohës ndodh sepse pa vdekje nuk ka nevojë të matet koha, prandaj nuk ka nevojë për kohën. Ideja se koha është thjesht një gjë shumë e ndërlikuar dhe nuk mund të shpjegohet nga shkenca në këtë moment, duket si një deklaratë e vjetruar, bazuar në atë se sa ka arritur shkenca në 20 vitet e fundit në fushën e fizikës.

Unë mendoj se koha është diçka që ne nuk mund ta kuptojmë thjesht për shkak të logjikës së mendjes sonë. Duke pasur parasysh filozofinë e njohur antike, nëse koha dhe vdekja do të ishin vërtet një iluzion, atëherë jeta do të ishte e pafundme, dhe ne të gjithë do të ishim të pavdekshëm dhe do të jetonim përjetësisht.

/Bota.al/

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enverti  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com

**SPORT**

**QENDRA SPORTIVE  
 'BUJQËSIA'  
 TEL: 045/82 82 82**

## Giresse: Miqësoret do të shërbejnë për t'u njohur me ekipin

Përzgjedhësi i ri i Kosovës, Alain Giresse, ka thënë se miqësoret ndaj Burkina Fasos dhe Zvicrës do të shërbejnë për t'u njoftuar me ekipin. "Ky grumbullim ka rëndësi për mua ngaqë do ta kemi mundësinë të njihemi për së afërmi me lojtarët, pastaj do të njoftohemi së bashku edhe me mënyrën e organizimit, punën dhe si do të funksionojmë në këto dy miqësore", ka deklaruar trajneri francez

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBËRI**

**PRISHTINË, 21 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll këtë muaj do t'i zhvillojë dy miqësore ndaj Burkina Fasos dhe Zvicrës. Përzgjedhësi i "dardanëve", Alain Giresse, ka thënë se këto ndeshje do t'i shërbejnë për njohjen me skuadrën dhe më pas do të jepet një raport më i qartë për objektivat. "Ky grumbullim ka rëndësi për mua ngaqë do ta kemi mundësinë të njihemi për së afërmi me lojtarët, pastaj do të

njoftohemi së bashku edhe me mënyrën e organizimit, punën dhe si do të funksionojmë në këto dy miqësore. Është shumë normale për një trajner të ri që t'i njohë kapacitetet e lojtarëve, por jo për ta ndërruar komplet strukturën. Duhet të vazhdojmë dinamikën e ekipit aty ku ka mbetur. Secili lojtar duhet ta tregojë veten në lidhje me objektivat që i kemi para vetes", ka thënë Giresse.

Ndeshjet që "dardanët" i zhvillojnë më 24 dhe 29 mars do të shërbejnë për ndeshjet e Ligës



së Kombeve të cilat fillojnë në muajin qershor. Në këtë ligë trajneri francez ka bërë me dije se ambiciet janë të mëdha. "Është hera ime e parë që do të jem në krye të ekipit. Këto dy ndeshje do të na ndihmojnë t'i shohim lojtarët dhe të përgatitemi sa më mirë për ndeshjet e qershorit. Në Ligën e Kombeve do të futemi me ambicie maksimale dhe këto dy miqësore do të na shërbejnë shumë në atë drejtim", ka shtuar Giresse, i cili ka folur edhe për

përballjen ndaj kombëtares zvicerane. "Zvicra vitet e fundit është në top formë dhe është një ndeshje shumë interesante dhe e mirë për ta parë veten se ku jemi. Në të njëjtën kohë është një matës i mirë për ta parë veten se ku jemi në krahasim me ekipet më të mëdha se ne", ka deklaruar ai.

Në konferencën për medie, Giresse është pyetur edhe për lojtarët që janë larguar nga ish-përzgjedhësi Bernard Challandes,

Bernard Berisha dhe Leart Paqarada. Me këtë rast ai ka njoftuar se dyert e përfaqësueses janë të hapura për të gjithë futbollistët. "Derën nuk ia mbyll askujt, por gjithmonë varet nga situata. Këto janë çështje që duhet të rregullohen. Ne do të përpiqemi t'i rregullojmë të gjitha ato probleme që mund të kenë ekzistuar. Më duhet të njihem më shumë me lojtarët dhe sigurisht se dera do të jetë e hapur për të gjithë", ka pohuar Giresse. Trajneri francez që do të debutojë në krye të Kosovës ka njoftuar se Emir Sahiti nuk do të grumbullohet për shkak të lëndimit.

Të hënën francezi drejtoi stërvitjen e parë të futbollistëve "dardanë" e cila u mbajt në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Dy miqësoret e këtij muaji do të luhen kundër Burkina Fasos, më 24 mars në stadiumin "Fadil Vokrri" dhe kundër Zvicrës, më 29 mars në Cyrih.

## Katër skuadra në garë për trofeun e Ligës Unike

**PRISHTINË, 21 MARS** - Katër skuadrat më të mira të Ligës Unike në konkurrencën e femrave do të përballen në garë për trofeun e kësaj gare. Ky është edicioni i parë dhe historik, andaj dëshira është e madhe për të fituar këtë trofe. Final 4 do të organizohet në Prishtinë, më 23 dhe 24 mars. Gjysmëfinalja e parë është mes Penzës dhe Bashkimit, një derbi në Ligën Unike. Pejanet përfunduan garat me tetë fitore e dy humbje, ndërsa prizrenaset me pesë fitore e pesë humbje. Vashat prizrenase fituan Kupën e



Kosovës dhe sigurisht e duan edhe trofeun e Ligës Unike, ashtu siç e duan edhe kampionet e Kosovës që kanë fituar Superkupën

Mbarëkombëtare të zhvilluar vitin e kaluar në Vlorë. Gjysmëfinalja tjetër është ndërmjet Prishtinës dhe Flamurtarit, që përfunduan

garat me nga shtatë fitore e tri humbje, si dhe me nga një fitore ndaj njëra-tjetrës. Prishtinaset si organizatore synojnë ta fitojnë trofeun e çmuar, ndërsa vashat nga Vlora udhëtojnë të bindura për të triumfuar. Spektakël i basketbollit pritët në Prishtinë për dy ditë, ndërsa hyrja do të jetë falas për adhuruesit e basketbollit.

**Shpërblimet për fituesin e Ligës Unike te femrat**

Më 23 dhe 24 mars në Prishtinë do të organizohet

Final 4 i Ligës Unike në konkurrencën e femrave. Në këtë Final 4 marrin pjesë katër skuadrat më të mira të kësaj lige: Prishtina, Bashkimi, Penza dhe Flamurtari. Në konkurrencën e femrave Liga Unike do të ofrojë shpërblime për dy gjysmëfinalistët nga 1 500, për finalistët nga 3 000 dhe për klubin i cili shpallet Kampion i Ligës Unike do të ndahen 6 000 (15 000 gjithsej). Ky është edicioni i parë dhe historik i Ligës Unike te femrat, ku do të mësohet kampioni i parë i kësaj gare.

## 'Dardanët' dhurojnë 30 bileta falas për komunitetet për ndeshjen miqësore Kosova - Burkina Faso

**PRISHTINË, 21 MARS** - Tifogrupi i Kosovës "Dardanët" ka vendosur të dhurojë 30 bileta dhe shalla pa pagesë për pjesëtarët e komuniteteve në Kosovë për ndeshjen ndaj Burkina Fasos. Lajmin e ka dhënë kryetari i "Dardanëve", Lulzim Berisha, në një shkrim të publikuar në "Facebook". "Ju njoftoj që si kreu i tifogrupit 'Dardanët' kam vendosur t'i ndaj 30 bileta dhe shalla falas për

bashkësitet tanë që i përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për ndeshjen ndaj Burkina Fasos. Jemi të hapur për të gjitha komunitetet dhe besojmë thëllësisht që vlerat që i përfaqëson shteti ynë, si dhe vetë përfaqësimi i futbollit tonë me anë të kombëtares - nuk kanë monopol monoetnik. Kosova u takon të gjithëve: çdo banori, pa marrë parasysh përkatësinë etnike

apo fetare", ka shkruar Berisha. Kosova do të ballafaqohet më 24 mars me Burkina Fason në stadiumin "Fadil Vokrri" në një ndeshje miqësore. Pesë ditë më vonë të përzgjedhurit e trajnerit Alain Giresse do të përballen në një tjetër takim kontrollues me Zvicrën, pjesë e së cilës janë edhe disa lojtarë nga Kosova, Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Andi Zeqiri.



## Januzi fiton për herë të dytë çmimin 'ylli i javës'

**KLINË, 21 MARS** - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta japin çmimin "ylli i javës". Këtë çmim për xhiron e 26 e ka fituar futbollisti i KF

Dukagjini, Ahmed Januzi. Sulmuesi me përvojë pati paraqitje të shkëlqyeshme në fitoren tejet të rëndësishme të skuadrës së tij kundër Llapit, me rezultat 2-1. Ai shënoi të dyja golat për arkëtimin e tri pikëve të mëdha në stadiumin "Zahir

Pajaziti" në Podujevë. Golin e parë e realizoi në minutën e 10, të dytin në minutën e 72-të. Për Ahmed Januzin kjo është hera e dytë që e merr këtë çmim, pasi ishte shpallur më i miri i javës edhe në xhiron e 7, në tetor të vitit të kaluar. Pas fitores në

Podujevë, KF Dukagjini (Klinë) mbetet në pozitën e 8-të, por arriti në kuotën e 29 pikëve. Çmimin "ylli i javës" për sulmuesin e skuadrës nga Klina e dorëzoi Elon Ademi, specialist në Departamentin e Kontabilitetit dhe Kontrollit Financiar në BKT.



## Krasniqi publikon listën e futbollistëve për dy miqësoret me Shqipërinë

**PRISHTINË, 21 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës U19 në futboll në fund të këtij muaji do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore me Kombëtaren e Shqipërisë U19. Ndeshja e parë do të luhet më 26 mars, në orën 15:00, derisa përballja e dytë e "dardanëve" të rinj me "kuqezinjtë" do të zhvillohet më 28 mars, në orën 10:00. Të dy këto takime do të luhen në stadiumin "Egnatia Arena" në Rrogozhinë. Këto dy miqësore do t'i shërbejnë përzgjedhësit Ramiz Krasniqi për ta krijuar një ekip sa më kompakt për kualifikimet e Kampionatit Evropian "Malta 2023", e ku "Dardanët" U19 janë në Grupin 3, së bashku me Ukrainën, Suedinë dhe Qipron. Për dy miqësoret me Shqipërinë, Krasniqi ka ftuar 22 futbollistë, shumica prej të cilëve janë nga kampionati vendor.



### LISTA E FUTBOLLISTËVE

Altin Gjokaj (FC Besa), Rinor Jahmurataj (FC Besa), Altin Mehaj (FC Besa), Drin Bajraktari (FC Ferizaj), Milot Ajeti (SC Gjilani), Blerjon Avdimetaj (FC Besa), Orges Mehmeti (FC Ferizaj), Uliks Spahiu (FC Besa), Arlind Maloku (FC Ballkani), Etnik Brutli (FC Besa), Rinor Toverlani (FC Llapi), Arianit Hasani (FC Llapi), Erion Sadriu (FC Ferizaj), Ermir Rashica (FC Trepça '89), Rion Selimi (FC Dukagjini), Eridon Maloku (FC Drita), Laurence Shala (FC Crystal Palace), Donart Lubishtani (FC Inter Milan), Gent Rexhepi (FC Xamax), Dion Ajvazi (Hertha Berlin BSC), Leart Haskaj (TSG 1899 Hoffenheim), Andi Kadriu (FC Trepça '89).

## Phoenixi marshon i vetëm, humbasin Golden State e Philadelphia

**SAN FRANCISCO, 21 SHKURT** - Skuadra e Golden States është mposhtur me rezultat 110-108 në fushën e saj nga San Antonio, ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Mungesa e Curryt u ndje te Warriors, ku u dalluan Poole me 28 pikë e Thompsoni me 24, por që s'mjaftuan. Për Spursin dallimin e bëri Richardsoni me 25 pikë. Fitore të vështirë jashtë fushës arriti edhe Phoenixi, që e mundi me shifrat 127-124 Sacramenton. Bookerit me 31 pikë e Bridges me 27 bënë dallimin në fushë për Suns, që mbeti skuadra më e



mirë në NBA. Kanadezët e reboundeve të Sakamit, mundën Torontos, falë 26 pikëve e 10 Philadelphian me rezultat 98-88.

### REZULTATET

Houston - Memphis	98-122
Indiana - Portland	129-98
Atlanta - New Orleans	112-117
Orlando - Oklahoma	90-85
Sacramento - Phoenix	124-127
New York - Utah Jazz	93-108
Denver - Boston	104-124
Philadelphia - Toronto	88-98
Golden State - San Antonio	108-110

### SHKURT

#### Gjimshiti ishte synim i Interit, por vazhdon kontratën me Atalantën

Mbrojtësi i kombëtares shqiptare, Berat Gjimshiti, ka firmosur rinovimin e kontratës me skuadrën e Atalantës. Palët kanë gjetur marrëveshjen mes tyre, me Gjimshitin që do ta mbajë veshur fanellën "bergamaske" edhe për katër vjetët e ardhshme, me klubin italian që ka "blinduar" mbrojtjen, teksa nuk bëhet me dije se sa do të jetë paga e lojtarit pas këtij rinovimi. Lajmin e ka dhënë vetë mbrojtësi shqiptar në rrjete sociale. "Jam shumë i lumtur dhe krenar që kam vazhduar kontratën me Atalantën. Mezi pres të kem shumë momente të tjera të suksesshme me këtë klub", ka thënë Gjimshiti. Kujtomë se mbrojtësi i kombëtares është kthyer në një pikë kyçe në formacionin e Gasperinit, teksa paraqitet e treguar nga lojtari e kanë ndihmuar Atalantën edhe për marrjen e rezultateve pozitive.

#### Xavi: Nuk e prisnim të ishim kaq superiorë në 'Santiago Bernabeu'

Barcelona e poshtëroi Real Madridin në "Santiago Bernabeu" me rezultat të thellë 4-0. Xavi ishte i befasuar me djemtë e tij të cilët zhvilluan një nga ndeshjet më të mira në gjithë sezonin edhe pse Barça të enjten kishte luajtur në Ligën e Evropës, por në "El Clasico" të gjithë ishin të motivuar për të treguar se Barcelona e vjetër është rikthyer. "Ishte një mbrëmje e këndshme për tifozët e Barcelonës. Nuk e prisnim të ishim kaq superiorë në stadiumin e tyre, por mund të kishim shënuar më shumë gola. Reali kishte një javë pushim, ndërsa ne u kthyem nga Turqia të premtën. Kemi luajtur një ndeshje spektakolare. Jam shumë i kënaqur. Dominuam ndaj Realit në çdo aspekt. Ishim dukshëm superiorë në lojë dhe rezultat. Kënaqësi e madhe. Largohemi të buzëqeshur", ka thënë Xavi.

#### Erikseni, pozitiv me Covid

Mesfushori i Danimarkës, Christian Eriksen, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Eriksen është ftuar nga kombëtarja daneze për herë të parë që nga sulmi në zemër që pësoi në fushë në "Euro 2020". Danezi nuk do të jetë në dispozicion për ta ndihmuar kombëtaren e tij për dy ndeshjet miqësore, pasi ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Federata daneze ka njoftuar se Erikseni mund t'i bashkohet skuadrës në ditët në vijim nëse rezultoni negativ. Danimarka do të zhvillojë miqësore me Holandën më 26 mars dhe Serbinë më 29 mars.

#### PSG-ja bllokon largimin e Messit dhe Ramosit

Paris Saint-Germaini është i gatshëm ta bllokojë çdo tentim për rikthimin e Lionel Messit në Barcelonë dhe të Sergio Ramosit në Real Madrid, ka njoftuar "Marca". Është raportuar në javën e kaluar se dy yjet e PSG-së janë të interesuar të rikthehen në skuadrat e mëparshme. Argentinasi Messi është i interesuar të rikthehet në "Camp Nou", pasi tash është trajner Xavi dhe forma e Barcelonës është gjithnjë në ngritje. Në anën tjetër, Ramosi nuk e ka gjetur veten në klubin francez pasi lëndimet e kanë përcjellë në vazhdimësi.

## Ancelotti, pas humbjes nga Barça: Unë jam fajtori

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, është shprehur i zhgënjyer me humbjen që pësoi skuadra e tij në derbin ndaj Barcelonës (0-4). Trajneri

italian e mori përgjegjësinë e plotë për këtë humbje turpëruese. "Është e vështirë pasi kjo është një 'El Clasico', shumë e rëndësishme për tifozët.

Është një goditje, ne e humbëm betejën, por e kemi ende avantazhin dhe duhet të qëndrojmë të qetë dhe t'i presim lojtarët e lënduar. Gjithçka

shkoi keq. Duhet ta harrojmë këtë lojë dhe të shikojmë përpara. E kemi një shkëputje të madhe në ligë. Unë kam faj", ka thënë Ancelotti.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Paykos" L.L.C. Veternik, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e produkteve nga granulati i drurit dhe plastikes (WPC) në Babush i Muhaxherëve në Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.04.2022 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Rozafa" adresa "Hajredin Bajrami", komuna Lipjan, do të organizohet debat publik nga Kompania "Paykos" L.L.C. Veternik, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e produkteve nga granulati i drurit dhe plastikes (WPC) në Babush i Muhaxherëve në Lipjan.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM  
<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Paykos" L.L.C. Veternik, Prishtinë për fabrikën për prodhimin e produkteve nga granulati i drurit dhe plastikes (WPC) në Babush i Muhaxherëve në Lipjan.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publikimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publikimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



### NJOFTIM

TRAFIKU URBAN SH.A njofton se me date 18.03.2022 mbyllet njoftimi i shpallur në gazetën ditore "Epoka e Re" me datën 01.03.2022 "Shprehje Interesi për ofrimin e shërbimeve të marketingut"

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "CC Apartmens" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810168395.
- ▶ Nakshije Maloku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1. 2. 3. 4 si dhe diplomën e shkollës së mesme të Bujqësisë "Arbëria" Gjilan.
- ▶ Nakshije Maloku shpall të pavlefshme dëftesat nga kl, 1 deri 8 të shkollës fillore "Selami Hallaqi" Gjilan.
- ▶ Shemsije Thaqi shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan.
- ▶ Shemsije Maloku shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "Arbëria" Gjilan.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

# Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:  
**044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

